

ANALIZË E SHKURTË
KU ËSHTË KALLDRËMI I PRIZRENIT?
Gusht 2014, Prizren

PËRMBAJTJE

| | |
|--|----|
| I. Hyrje | 2 |
| II. Çka është Kalldrëmi? | 2 |
| III. Prizreni dhe Kalldrëmi | 3 |
| IV. Vendimmarrja pa përfshirje dhe mungesa e memories institucionale | 5 |
| V. Instituti i përjashtuar | 6 |
| VI. Zhdukja e kalldrëmit të larguar | 6 |
| VII. Trashëgimia kulturore e Prizrenit mbetet lakuriq pa kalldrëmin | 7 |
| VIII. Plani i konservimit dhe udhëzuesi për zbatimin e tij | 8 |
| IX. Gjendja aktuale e trashëgimisë kulturore dhe debati për rikthimin e kalldrëmit | 9 |
| X. Shembujt e qyteteve që mund të ndiqen | 11 |
| XI. Përfundim | 12 |
| XII. Për projektin | 12 |
| XIII. Pse monitorimi i Urbanizmit të Prizrenit? | 12 |
| Referencat | 15 |
| EC Ma Ndryshe | 16 |

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm", i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Saraqët 5, 20000/Prizren ~ Perandori Dioklician 14 (kati V), 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

I. Hyrje

Prizreni, si qendër urbane, prej shekujsh dallohet me karakteristikat arkitektonike të saj. Përgjatë historisë qyteti është ndërtuar me materiale tradicionale, në mesin e të cilave kalldrëmi përbën identitetin historik të rrugëve e rrugicave të tij. Si i tillë, kalldrëmi i ka dhënë karakter dhe hijeshi shesheve e rrugëve të Prizrenit në të kaluarën, dhe vazhdon ta bëjë këtë edhe sot e kësaj dite në pjesët e mbetura.

Kjo kulturë e shtresuar gjatë shekujve, që është trashëguar deri në ditët e sotme, është ballafaquar me rrezikun e zhdukjes nga rrugët e Prizrenit për shkak të intervenimeve në emër të zhvillimit të infrastrukturës moderne, duke injoruar në tërësi pjesën identitare të qendrës urbane e historike të qytetit. Madje, pushteti lokal i ka ndër marrë këto veprime me një qasje autoritative, pa asnjë debat gjithëpërfshirës dhe me bindjen se vetëm establishmenti komunal e di se çka është më e mira për qytetin dhe qytetarët.

Si pasojë e kësaj qasjeje, në vitet e pasluftës, në disa rrugë qendrore të Prizrenit është larguar kalldrëmi dhe është zëvendësuar me asfalt. Në emër të lehtësimit të qarkullimit rrugor të automjeteve është sakrifikuar një nga elementet e identitetit historik të qytetit. Dhe kalldrëmi i larguar është depozituar në dy lokacione, me evidencë që nuk shquhej për saktësi. Ndërkohë historia e vendimmarrjes për largimin e kalldrëmit bashkë me projektet e hartuara do të shlyhej nga memoria institucionale e komunës së Prizrenit shkaku i zjarrit që kishte kapluar ndërtesën e administratës lokale.

Kështu hiri ka mbuluar shumë pyetje që ende mbeten pa përgjigje. Për përgjegjësi e llogaridhënie as që është bërë fjalë. Por ajo çka

është e sigurt, është se Prizrenit i është gjymtuar një pjesë e identitetit, që vështirë se mund të kthehet ndonjëherë, marrë parasysh mendësinë që mbizotëron aktualisht te organet komunale dhe qeveritare.

Prandaj ky raport, më shumë vjen si një kontribut në drejtim të promovimit të vlerës së kalldrëmit, dokumentimit të dëmit që i është shkaktuar qytetit me largimin e tij nga rrugët qendrore, parashtrimit të nevojës për ruajtjen e tij dhe eventualisht hapjen e debatit për rikthimin e këtij materiali në përdorim së paku në zonën qendrore të Prizrenit.

II. Çka është Kalldrëmi?

Rrugët e një shteti janë teste të sakta dhe të besueshme mbi shkallën e qytetërimit të tij¹. Romakët ishin të parët që i kushtuan rëndësi ndërtimit të rrugëve dhe krijimit të rrjetit të tyre. Ndërtuesit romakë të rrugëve veçanërisht përmirësuan mënyrën e ndërtimit të kalldrëmit. Fjala kalldrëm i referohet blloqeve apo kubëzave të gurit natyror, të latuar, në madhësi dhe tipe të ndryshme. Romakët i kushtuan vëmendje të posaçme bazës rrugore dhe ndoshta për shkak të kësaj ende ka qasje shumë mbetje të rrugëve të tyre në të gjithë territorin e ish-Perandorisë Romake². Pra historiku i përdorimit të përhapur të kalldrëmit daton prej kohës antike, me ç'rast me kalimin e shekujve

¹ Gillespie, William Mitchell, 1848. A Manual of the Principles and Practice of Road-Making: Comprising the Location, Construction, and Improvement of Roads (Common, Macadam, Paved, Plank, etc.) and Rail-Roads.

New York: A. S. Barnes & Co.

² "Roman roads in Croatia", A. Deluka, V. Dragcevic, T. Rukavina, Proceedings of the First International Congress on Construction History, Madrid, 20th-24th January 2003

ka marrë formë e tipare të ndryshme dhe është karakteristike e qyteteve historike³. Kalldrëmi është material tradicionalisht i përdorur në qendrat urbane jo vetëm në Kosovë dhe tashmë është shndërruar në pjesë identitare dhe përbërëse të zonave historike⁴. Derisa periudha e mëparshme e krijimit justifikonte kalldrëmin si më të mirë, zgjedhje më racionale dhe moderne, në periudhën aktuale kalldrëmi vlerësohet për shkak të vjetërsisë: lidhjes me autencitetin e pamjes historike⁵.

III. Prizreni dhe Kalldrëmi

Prizreni për një kohë të gjatë ka qenë qendër e rëndësishme ekonomike, kulturore dhe e artizanëve në rajon. Gërmimet arkeologjike kanë treguar se vendbanimet këtu datojnë që nga epoka e bronzit dhe e hekurit. Qyteti i Prizrenit përbëhet nga qendra e tij historike (Zonat e Mbrojtura 1 dhe 2), të rrethuara me një tampon zonë 3, e cila shtrihet në mes të shtrirjes së qytetit në periferi dhe qendrës së tij kompakte urbane⁶.

Prizreni e ruan ndjenjën e shtresëzimit të larmishëm arkitektonik që përcakton karakterin e tij dhe dëshmon historinë e tij, duke përfshirë

edhe ato ndryshime urbane, arkitektonike dhe stilistike të shekullit XX që i kanë shoqëruar ndryshimet politike dhe ideologjike, siç ishte socializmi, dhe i pasqyron interpretimet e tyre lokale. Në qytet janë disa monumente të mbrojtura fetare (islame, katolike dhe ortodokse), përfshirë edhe një monument të Trashëgimisë Botërore të mbrojtur nga UNESCO (Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë), bashkë me monumente të rëndësishme qytetare (Hamami, urat dhe shatërvanët). Çka është me rëndësi, ka mbetur edhe një numër i shtëpive të vjetra tradicionale të cilat të vëna përbri këtyre monumenteve dhe skalitjet e strukturës urbane, paraqesin një shembull koherent të kontekstit të trashëgimisë kulturore urbane në Kosovë⁷. Emëruesi i përbashkët për lidhjen e këtyre objekteve kanë qenë rrugët e shtruara me kalldrëm.

Qytetarët e Prizrenit ndjejnë nostalgji për kalldrëmin, që është mënjanuar nga rrugët kryesore të qytetit. Për ta kalldrëmi është kujtimi për qytetin. Në kujtesën e Jeton Jagxhiut⁸ ende jehon zhurma e veçantë e gomave të veturës, kur ai me prindërit e vet udhëtonte në ulëset e prapme. Sa herë që e ka dëgjuar këtë zë, ai e ka ditur se ka hyrë në Prizren. Prandaj, kalldrëmi për të është simbol i qytetit. Sipas tij, Prizreni duke qenë se ka qenë pjesë e rrugëve antike brenda vetes ka lloje të ndryshme të kalldrëmit, duke filluar nga ai romak, bizantin, mediteran, francez, e oriental që është përbërë prej gurëve të sheshtë të lumit. Për këtë arsye konsideron se kalldrëmi është gur dokument që e tregon historinë e qytetit.

³ Informatë në

<http://www.pavingexpert.com/setts01.htm>, qasur më 6 qershor 2014

⁴ Komunikatë, CHwB, 2012-11-06,

<http://chwb.org/kosovo/news/ne-perkrahje-te-vlerave-te-trasheguara-dhe-te-drejtjes-se-komunitetit-per-ti-gezuar-ato/?lang=sq>, qasur më 7 qershor 2014

⁵ "Excavating Cobblestones: Obsolescence and the Reinterpretation of Stones", Mark Treskon, 2006, <http://www.nyu.edu/classes/bkg/objectsblog/archives/cobblestones.pdf>, qasur më 13 qershor

⁶ "Portrete të Zonave Historike në Kosovë dhe rajonin ballkanik", broshurë, ChwB, mars 2011, <http://www.librariaelektronike.com/pdf/46>

⁷ Po aty

⁸ Jeton Jagxhiu, qytetar dhe aktivist, intervistë, maj 2014

Ndërsa Refet Bushati⁹ kujton se si në vitet e 50'ta të shekullit të kaluar pothuajse të gjitha rrugët e Prizrenit kanë qenë të shtruara të kalldrëm. Në këtë kohë sipas tij në qytet ka qenë mjaft e përhapur edhe tradita e kujdesit të komunitetit ndaj kalldrëmit respektivisht pastërtisë së rrugës.

Enver Batiu¹⁰ konsideron se Prizreni trashëguar një të kaluar interesante duke qenë në qendër të rrugës së vjetër Nish-Lezhë. Sipas tij pos veçorive natyrore, qyteti gjatë historisë ka krijuar edhe dije, intelekt, kulturë dhe trashëgimi në aspektin e jetës së përditshme. Për bindjen e tij, kalldrëmi apo shtroja e rrugëve, është njëra prej këtyre karakteristikave. Pllakat e gurit të qëndrueshëm, apo të strallit, sipas Batiut, fillimisht janë tërhequr nga malet e Sharrit, ku shtrojat e para janë vendosur në pjesën qendrore të qytetit, respektivisht rreth faltoreve krishtere, që si pasojë ka sjellë edhe deri te krijimi i çarshisë së parë, që quhej çarshia e priftit. Me kalimin e kohës qyteti zgjerohet dhe paralelisht rritet shtrimi i rrugëve me kalldrëm. Batiu tregon se për kalldrëm janë përdorur gurët e lëmuar të lumit që po ashtu i kanë dhënë një karakteristikë të veçantë rrugëve të Prizrenit.

Gjatë historisë kalldrëmi bëhet pjesë emancipimit dhe civilizimit të qytetit, ngase pos rrugëve sipas Batiut ato futen edhe në oborret e shtëpive, në mënyrë që të mos bartet balta. Tërë ky ambient, për historianin që ka jetuar për shumë dekada në Prizren, ka krijuar një ambient natyral, që gjatë ditëve të ngrohta të verës ka krijuar freski, derisa gjatë të ftohtit të dimrit ka penguar ngricat në rrugë. Por edhe muzikalitet gjatë ecjes mbi to.

Situata për Batiun nis të ndryshoj në vitet e 70'ta, kur kalldrëmi prej gurëve të lëmuar zëvendësohet me kalldrëmin prej kubëzave të gurit. Në këtë periudhë nis edhe ndërtimi me beton në qendër të Prizrenit, që sipas tij, e humb balansin e ambientit jetësor.

Për më shumë ndjesia e qytetarëve të Prizrenit për kalldrëmin është manifestuar edhe në një artikull të Wall Street Journal, të botuar në vitin 2008, ku flitet për Kosovën si destinim turistik, me ç'rast një qytetar i intervistuar deklaroi se "të gjitha rrugët kanë qenë me kalldrëm"¹¹. Kalldrëmi si vlerë e Prizrenit figuron edhe në shumë artikuj e reportazhe të medieve botërore.

Kubëzat e granitit e ruajnë një vazhdimësi të traditës në rrugët e qytetit, deri në vitet e pasluftës së fundit. Në këtë periudhë, pra në vitet 2001-2006, komuna e Prizrenit merr vendime dhe zbaton projekte për largimin e kubëzave të granitit dhe në vend të tyre shtron asfalt, siç është rasti në rrugët "Adem Jashari" dhe "Ismet Jashari – Kumanova".

Madje është larguar edhe kalldrëmi nga rrugët që sot janë pjesë përbërëse e Qendrës Historike të Prizrenit, siç ka qenë rasti te rruga "Vatrat Shqiptare", te Kompleksi Marash. Rruga ka qenë e shtruar me kalldrëm deri në vitin 2003, kur u zëvendësua me blloqe të betonit¹². Në të njëjtën kohë oborret e pothuajse të gjitha

¹¹ WSJ, "Europe's Unlikely Charmer", Stan Sesser, June 27, 2008, <http://online.wsj.com/news/articles/SB121452066620808827>, qasur më 12 qershor 2014

¹² "Arkitektura Tradicionale dhe Metodrat e Dokumentimit", publikim i CHwB, Zyra e Kosovës, 2010, faqe 208, http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/06/CHwB-Kosovo-Report-15_2010-Traditional-architecture-and-documentation-methodologies.pdf

⁹ Refet Bushati, orëtar, intervistë, maj 2014

¹⁰ Enver Batiu, historian, intervistë, maj 2014

shtëpive të vjetra dhe me vlerë të Prizrenit kanë qenë të shtruara me kalldrëm.

IV. Vendimmarrja pa përfshirje dhe mungesa e memories institucionale

Ish-pushtetarët e Prizrenit arsyetojnë se ndërrimi i kubëzave të granitit (kalldrëmit) në këto dy rrugë ka qenë e domosdoshme, për shkak të qarkullimit të automjeteve të rënda dhe vështirësisë së mirëmbajtjes. Ata kanë bërë të ditur se debati është zhvilluar brenda organeve komunale, në ekzekutiv dhe legjislativ. Mirëpo nuk ka pasur përfshirje të komunitetit në debatin në lidhje me ndryshimin e karakteristikës dhe imazhit të rrugëve të Prizrenit.

Hanefi Muharremi¹³ ka thënë se me ardhjen në pushtet të LDK-së nga viti 2001, me parashikimet afatmesme, Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prizrenit ka paraparë rindërtimin e rrugëve "Adem Jashari" dhe "Ismet Jashari-Kumanova", pasi që qarkullimi i automjeteve të rënda i kishte bërë kubëzat të paqëndrueshme dhe mirëmbajtjen e tyre të pamundur. Vendimi që këto kubëza të largohen, sipas tij, është bërë pas debateve të shumta në Bord dhe në ish-Kuvendin Komunal, me konstatimin që kubëzat e larguara të përdoren në trotuare apo edhe në rrugica të ndryshme afër qendrës së qytetit. Për këtë çështje thotë se ka pas konsulta edhe me ekspertë dhe se nuk ka pas zgjidhje tjetër më adekuate.

Ai ka theksuar se leja e ndërtimit për projektet e dy rrugëve është marrë në mënyrë të rregullt dhe se drita përfundimtare e gjelbër është dhënë nga përfaqësuesit e UNMIK-ut. I tërë

¹³ Hanefi Muharremi, ish-drejtor i Komunikacionit, Komuna e Prizrenit, intervistë, maj 2014

dokumentacioni në lidhje me këto projekte sipas tij ka qenë në ndërtesën e administratës komunale dhe nuk ka dijeni nëse ato ende ekzistojnë, shkak i zjarrit që kishte përfshirë ndërtesën e komunës.

Qeveria aktuale komunale ka bërë të ditur se nuk ka të dhëna në lidhje me rrjedhën e rindërtimit të rrugëve para janarit të 2008-ës. DSHP përmes një shkrese ka njoftuar se nuk ka ndonjë informacion në këtë drejtim¹⁴. Ndërsa DUPH-ja ka sqaruar se nuk posedon dosje apo shkresa lidhur me lejet e ndërtimit nga viti 2000 deri në vitin 2007, "ngase një pjesë e dosjeve të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor janë të djegura, me rastin e djegies së Komunës së Prizrenit"¹⁵.

Por pushtetarët aktual pajtohen se me largimin e kalldrëmit është dëmtuar imazhi i rrugëve të Prizrenit.

Për më shumë nuk janë respektuar as standardet ndërkombëtare, që nënvizojnë se ndërhyrjet e tilla duhet të bazohen mbi respektin ndaj materialit origjinal¹⁶.

Hasan Hasani¹⁷ thotë se qeverisja e PDK-së nga dita e parë e punës është dashur të ballafaqohet me godinën e djegur të komunës, që ka djeg një pjesë të historisë së qytetarëve. Ai ka theksuar se PDK-ja derisa ka qenë në opozitë ka dhënë vërejtjet e veta që mos të punohet në dëm të Prizrenit dhe të ruhet trashëgimia e rrugëve të qytetit. Sipas tij, rindërtimi i rrugëve "Adem Jashari" dhe "Ismet Jashari-Kumanova" nuk janë planifikuar mirë,

¹⁴ DSHP, qasje në dokumentet publike, 2 prill 2014

¹⁵ DUPH, qasje në dokumentet publike, 14 prill 2014

¹⁶ Karta e Venedikut, artikulli 9,

http://www.icomos.org/charters/venice_e.pdf

¹⁷ Hasan Hasani, drejtor aktual i DSHP-së, intervistë maj 2014

punimet nuk janë realizuar si duhet dhe në tërësi ka pas gabime të pafalshme, që nuk lidhen vetëm me largimin e kalldrëmit dhe shtrimin e asfaltit. Madje projektin e rrugës “Adem Jashari” e ka cilësuar si të dështuar.

Në bindjen e tij, ani pse mirëmbajtja e kalldrëmit është më i vështirë dhe më i kushtueshëm, nuk ka diskutim se duhet ruhet ngase përfaqëson të kaluarën e vendit dhe ndihmon turizmin.

Ndërkaq Sadik Paçarizi¹⁸ kalldrëmin e sheh si pjesë të historisë së Prizrenit, që ka krijuar edhe imazhin për jetën e qytetarëve të këtij vendbanimi. Ai vlerëson se nga rrugët e qytetit janë larguar sasi të mëdha të kalldrëmit dhe se rruga “Adem Jashari” ka përjetuar shëmtinë më të madhe me largimin e tij.

Hartuesit e këtij raporti kanë tentuar që të marrin edhe qëndrimin e ish-kryetarit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Eqrem Kryeziu, i cili njëherë ka pranuar që të intervistohet, por më pastaj ka anuluar takimin, duke sqaruar se përgjigjet mund të merren nga Hanefi Muharremi.

V. Instituti i përjashtuar

Edhe pse çdo intervenim në pjesën historike të qytetit kërkon tretman të veçantë, duke marrë pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike që tani quhet Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, një gjë e tillë sipas punonjësve të këtij institucioni nuk ka ndodhur.

¹⁸ Sadik Paçarizi, ish-DSHP dhe Ish-DUPH, intervistë, maj 2014

Hasan Hoti¹⁹ ka theksuar se investitori që në këto raste ka qenë komuna e Prizrenit asnjëherë nuk ka kërkuar pëlqim nga IMMH-ja për intervenimet që janë bërë në rrugët e kësaj zone. Ai ka njohuri se punonjësit e IMMH-së kanë reaguuar në vitet 2003-2004 në lidhje me largimin e kubëzave në rrugët “Adem Jashari” e “Ismet Jashari-Kumanova”, pasi nuk është kërkuar pëlqimi i IMMH-së, por pa asnjë rezultat. Ai shton se mendësia e realizimit të projekteve pa pëlqim të IMMH-së vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Enver Batiu, një ish-punonjës i IMMH-së, ka bërë të ditur se intervenime të shumta janë bërë pa projekt, pa plan dhe pa konsultime me punëtorët shkencor. Kjo praktikë sipas tij ka ndodhur edhe në rastin e largimit të kalldrëmit dhe shtrimit me asfalt, me ç’rast kubëzat e granitit janë hequr në mënyrë tinëzare duke dëmtuar të kaluarën e këndshme të qytetit dhe duke prishur atmosferën e trashëguar të Prizrenit.

Në këtë drejtim mos koordinimi i duhur ndërmjet Komunës, IMMH-së dhe MKRS-së, sipas Batiut ka shkuar në dëm të Prizrenit, ngase qyteti po e humb formën e tij dhe po lëngon për mirëmbajtje të vërtetë. Batiu konsideron se nëse nuk ndalet ky trend, atëherë Prizreni rrezikon të bëhet si qytetet që nuk kanë trashëgimi kulturore.

VI. Zhdukja e kalldrëmit të larguar

Kalldrëmi i larguar nga rrugët kryesore të Prizrenit është depozituar në dy lokacione të ndryshme, për përdorim të mëtejshëm, në projektet infrastrukturore të Komunës së

¹⁹ Hasan Hoti, drejtor i IMMH (QRTK), intervistë, maj 2014

Prizrenit. Mirëpo ruajtja e tyre nuk është bërë në mënyrë strikte, kështu që me to kanë mundur të shërbehen edhe individët, duke i përdorur për nevojat personale dhe duke humbur kështu përgjithmonë një material që ka qenë pronë publike e qytetit.

Hanefi Muharremi shpjegon se vendimi i komunës ka qenë që këto kubëza të largohen dhe të ruhen për përdorim gjatë ndërtimit të rrugëve në qendër të qytetit. Pjesa e parë e kalldrëmit sipas tij është depozituar në parkingun përballë qendrës sportive dhe sipas nevojë përdorej nëpër trotuare. Ai pranon se në këtë hapësirë nuk ka pas mbikëqyrje dhe se qytetarë të ndryshëm i kanë marrë ato për nevojat e tyre për t'i shtruar oborret në shtëpi. Ndërsa në rastin e largimit të kalldrëmit nga "Ismet Jashari-Kumanova" kubëzat janë depozituar në deponë e "IS Company" dhe pranim-dorëzimi bëhej me procesverbale.

Sadik Paçarizi vlerëson se nga rrugët e Prizrenit janë larguar sasi të mëdha të kalldrëmit dhe sipas tij qeveria e LDK-së është përgjegjëse për shkatërrimin dhe humbjen e kubëzave. Ai nuk i beson thashethemeve që kubëzat të jenë shitur diku jashtë, ani pse ka dëgjuar vlerësimet të larta për strukturën, formën dhe karakteristikat e këtij kalldrëmi. Edhe Paçarizi beson se kalldrëmi gjendet te individët në oborre shtëpish, ku madje thekson se në dy raste është kërkuar që kubëzat nga individët të kthehen në depo. Megjithatë pranon se edhe komuna e Prizrenit në dy raste ka dhuruar një sasi kubëzash si donacion për një monument dhe një vend tjetër.

Ndërsa Hasan Hasani është i prerë se ish-pushtetarët duhet të japin përgjegjësi për humbjen e kalldrëmit. Sipas tij kush i ka keqpërdorur ato duhet të përgjigjet. Hasani është i bindur se ka probleme me funksionimin

e sistemit të drejtësisë, ngase në të kundërtën deri më tani dikush është dashur të japë llogari për këtë para gjyqësorit.

VII. Trashëgimia kulturore e Prizrenit mbetet lakuriq pa kalldrëmin

Studiuesit vendor të trashëgimisë kulturore vlerësojnë se kalldrëmi është një material autentik që e bën të plotë imazhin e pjesës urbane të qyteteve të vjetra. Pa të nuk kanë kuptim as objektet historike. Prandaj ruajtja e kalldrëmit është pjesë e pandashme e luftës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Bekim Çeko²⁰ thotë se kalldrëmi mban shenja të civilizimit njerëzor në përgjithësi. Pos shenjës nostalgjike e ka edhe anën teknike, që përmban atributet e trashëgimisë kulturore, veçanërisht asaj ndërtimore. Madje shton atributet e perceptimit të trashëgimisë kulturore në përgjithësi, ngase përbën teksturën që përshkruan edhe objektin. Për bindjen e tij, trashëgimia jonë kulturore mbetet e zhveshur pa kalldrëmin.

Kalldrëmi sipas tij është guri dokument që tregon zhvillimin e Prizrenit, si atë luftarak, zejtar, tregtar, që sjell me vete edhe ndërveprimin e civilizimeve të ndryshme. Prandaj përhapja e kalldrëmit si mjet urban në zonën historike është element integral i trashëgimisë kulturore. Në rastin konkret rruga "Adem Jashari" sipas Çekos ka pamje tjetër tani dhe i ngjan "pikturës pa sfond".

Sali Shoshi²¹ shpjegon se kalldrëmi paraqet materialin autentik që është përdorur nëpër pjesët urbane në Ballkan dhe në pjesën

²⁰ Bekim Çeko, arkitekt, intervistë, maj 2014

²¹ Sali Shoshi, arkitekt, CHwB, intervistë, maj 2014

evropiane të Mesdheut, sidomos në Perandorinë Osmane. Është i pranishëm në të gjitha çarshitë e Kosovës, dhe ka evoluar prej formave të ç'rregullta në kohët e mëhershme deri në kubëza në shekullin XX, madje edhe duke marrë emrin kalldrëmi shqiptar.

Përparësitë e kalldrëmit sipas Shoshit është se lehtë mirëmbahet dhe kur ka devijime mundën personat fizik ta heqin e ta kthejnë në vend, pa problem. Ky material, gjatë sezoneve me reshje, mundëson që uji të depërton nëpër fuga dhe parandalon ngricat.

Shoshi konsideron se në çdo aspekt kalldrëmi është më i lirë sesa përdorimi i materialeve të reja, ngase njëherë është punuar me të dhe ka mjeshtër vendor. Ai shton se një prej parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm është energjia e mishëruar që nënkupton se njëherë është harxhuar energji për prodhimin e materialit. Gjithashtu vlerëson se kostoja nuk ka rëndësi dhe se nuk mund të krahasohet me vlerën e materialit, që është pjesë e kontekstit urban të qytetit. Kjo strukturë urbane i ka disa elemente rëndësishme, si druri, tjegulla dhe rruga me kalldrëm. Pa kalldrëm pjesa urbane sipas Shoshit është e cunuar dhe rrezikohet autenciteti. Ai shpjegon se asfalti mund të lejohet vetëm nëse punohet një rrugë e re dhe jo mbi rrugën ekzistuese ku ka qenë i pranishëm kalldrëmi. Cenimi i vlerave në këto raste sipas tij është evident dhe nuk duhet ekspertizë për ta konstatuar një gjë të tillë.

VIII. Plani i konservimit dhe udhëzuesi për zbatimin e tij

Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2008 pati miratuar Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit. Ky dokument

përcakton parametrat e mbrojtjes dhe zhvillimit të qendrës historike, si dhe përfshin analiza të zonës lidhur me transportin në zonën e planifikuar, shfrytëzimin e tokës dhe shfrytëzimin e ndërtesave në katin përdhes dhe katin e parë, gjendjen e ndërtesave, etazhitetin e ndërtesave, materialet ndërtimore, pronat, zotërimin e ndërtesave, përshtatshmërinë e ndërtesave me strukturën fizike të zonës dhe rrethinës së saj²².

Plani i Konservimit përkufizon edhe normativat për pamjen e qytetit dhe rrugëve, me ç'rast theksohet se "materiali për shtrimin e rrugës duhet të respektojë rrethinën e objekteve të trashëgimisë dhe duhet të ketë ngjyrë dhe teksturë subtile".

Nga ky Plan ka derivuar edhe Udhëzuesi për zhvillimin e zonës historike të Prizrenit²³ që përkufizon Karakteristikat e Imazhit të qytetit dhe rrugës. Në tërë Zonën Historike imazhi i qytetit dhe rrugës kanë një rëndësi parësore pasi që janë ato që e bëjnë qendrën historike si një zonë unike të trashëgimisë kulturore dhe të një mjedisi të ndërtuar me cilësitë lartë. Për këtë arsye, Udhëzuesi parasheh që inventari rrugor, inventari komercial i rrugëve, ndriçimi, materialet e rrugës dhe shtrojës duhet të jenë të zgjedhura ashtu që të ruajnë, rrisin dhe sigurojnë harmoninë me karakterin tradicional.

I tërë zhvillimi (në rrugë dhe shtroja) duhet patjetër të mbështetet në kriteret vijuese: Rruga e re dhe trotuari duhet të jetë estetikisht

²² Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit, <http://www.online-transparency.org/repository/docs/Plani-i-konservimit.pdf>, qasur më 8 qershor 2014

²³ Udhëzuesi për zhvillimin e zonës historike të Prizrenit, <http://kk.rks.gov.net/prizren/getattachment/Projects/Planet-Rregullative/DARDANIA/PRIZREN-PP2-DCP-V6-JBAH-220310-ALB-final.pdf.aspx>, qasur më 8 qershor 2014

në përputhje me stilin dhe karakterin tradicional; Materiali i rrugës dhe trotuarit duhet të jenë me origjinë lokale/regjionale; Shtroja me vlerë të lartë është e nevojshme, duhet të mirëmbahet dhe restaurohet; Kalldrëmi origjinal dhe shtroja tjetër lokale brenda Zonës Historike duhet të mirëmbahet, riparohet dhe rikthehet në vendin e vet nëse është e nevojshme (kalldrëmin nga graniti), ku teknologjitë tradicionale duhet të përdoren; Kalldrëmet origjinale apo shtroja lokale nëse është e nevojshme duhet të ruhen dhe rivendosen; Materialet e përdorura për rrugë të automobilistike duhet të jenë me ato dimensione që të kenë forcën për të përballuar qarkullimin e automjeteve, minimum 8 cm., etj.

Sali Shoshi konsideron se vetëm në rehabilitimin e rrugës së Farkëtareve, është bërë punë e mirë nga qeveria lokale, derisa në rrugët tjera nuk ka pas konsultë. Ai insiston se plani i konservimit, tregon se si duhet trajtohen rrugët në pjesën historike të Prizrenit, por edhe elementet tjera, në mënyrë që të ruhet shpirti historik i qytetit. Sikur të respektohej ky Plan sipas tij as nuk do të kishte gabime. Ai thekson se ka pas plot devijime nga Plani i Konservimit dhe se duhet vetëdijesim i pushtetit lokal që të ruhet e rikthehet kalldrëmi. Madje sipas kjo është një kërkesë ligjore komunale dhe se çdo devijim nga Plani i Konservimit në Prizren paraqet shkelje ligjore.

IX. Gjendja aktuale e trashëgimisë kulturore dhe debati për rikthimin e kalldrëmit

Aprovimi i ligjeve dhe krijimi i mekanizmave të reja, nuk kanë sjellë ndonjë efikasitet në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Fati i kalldrëmit, i përshkruar më sipër në

raport, në një mënyrë është tregues i vet fatit të qytetit gjatë dekadave të fundit.

Në raportet e mëhershme të “EC Ma Ndryshe” është konstatuar se mos zbatimi i përpiktë i Planit të Konservimit dhe ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës kanë bërë që në Qendrën Historike të merr hov degradimi duke dëmtuar në mënyrë të pamëshirshme vlerat e trashëgimisë kulturore. Përgjatë kësaj periudhe Prizreni është shndërruar në model të shpjegimit se si nuk duhet realizuar zhvillimin urban²⁴.

Kosova ka kornizë legjislative dhe institucionale të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit, përveç legjislacionit bazik (trashëgimia kulturore dhe planifikimi hapësinor) janë miratuar edhe ligjet për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ai për Qendrën Historike të Prizrenit. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit kërkon nga Komuna e Prizrenit, që në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit të hartojë, miratojë dhe zbatojë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik që kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Trashëgiminë kulturore²⁵.

Edhe misioni i OSBE-së në Kosovë, përmes aktiviteteve të tij të monitorimit, ka vërejtur që vazhdon të ketë mangësi në zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

²⁴ “Qendra Historike e Prizrenit: Zonë e (Pa)Mbrojtur, http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_UW-Qendra_Historike_Zone_e_%28Pa%29Mbrojtur.pdf, qasur më 10 qershor 2014

²⁵ Po aty

dhe institucionet përgjegjëse vazhdojnë të jenë në masë të madhe joefektive²⁶.

Ky mision ndërkombëtar ka konstatuar se ndonëse ka shumë hisedarë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mungon një mekanizëm i qartë bashkërendues dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet institucioneve relevante bëhet vetëm sipas rasteve. Pavarësisht nga natyra tej-sektoriale e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe qendrore dhe ndërmjet departamenteve të ndryshme komunale dhe ministrive të ndryshme të linjës mbetet i kufizuar²⁷.

Mirëpo Hasan Hoti i IMMH-së shpjegon se komuna pothuajse asnjëherë nuk ka kërkuar pëlqim nga ky institucion për intervenimet që bëhen në rrugët e kësaj zone. Ai sqaron se në periudhën sa është drejtues i IMMH-së, janë bërë intervenime të ndryshme në Shadërvan, pa projekt, pa skicë dhe pa pëlqim të IMMH-së, dhe se pas përfundimit të punimeve ka pasur ndonjë kërkesë formale.

Sa i përket mundësisë për rikthimin e kubëzave ai thekson se së paku duhet të ruhet zona historike e qytetit dhe në të gjitha rrugët e kësaj zone të kthehet kalldrëmi. Ndërkaq vendosjen e kubëzave në rrugët me komunikacion të dendur nuk e sheh si ide të përshtatshme.

Sali Shoshi i CHwB-së thekson se kalldrëmi duhet të kthehet si material në rrugët e Prizrenit, sepse është pjesë e tërësisë së trashëgimisë kulturore dhe për më shumë është

²⁶ "Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë", OSBE, Mars, 2014,

<http://www.osce.org/sq/kosovo/117277?download=true>

²⁷ Po aty

një kërkesë obligative që del nga Plani i Konservimit, të miratuar nga Komuna.

Hanefi Muharremi, ish-drejtor i Komunikacionit thekson se ideja për kthimin e kalldrëmit në rrugën "Adem Jashari" nuk është realiste, për shkak se bëhet fjalë për një rrugë me qarkullim të dendur. Për kthimin e kalldrëmit në këtë rrugë sipas tij duhet gjetur alternativa për qarkullimin e mjeteve të rënda. Ai vlerëson se rruga duhet ta ketë fillimin, mbarimin dhe kuptimin, ndërkohë që mirëmbajtja e trashëgimisë kërkon burime të shumta.

Sadik Paçarizi, ish drejtor i DSHP-së dhe DUPH-së, është kategorik që kalldrëmi të kthehet në rrugët e Prizrenit. Kjo detyrë, sipas tij i takon të gjitha institucioneve dhe partive politike, që duhet të angazhohen më shumë dhe në mënyrë më të sigurtë në këtë drejtim.

Hasan Hasani, drejtor aktual i DSHP-së thotë se nuk duhet të ekzistojë debati, kalldrëm apo asfalt. Vitin e kaluar ai e ka bërë një premtim publik se ekzekutivi i Prizrenit do të punojë në drejtim të kthimit të kalldrëmit në rrugët e qytetit. Sipas tij ruajtja e të kaluarës dhe traditës nuk ka çmim dhe pushteti lokal duhet të angazhohet në këtë drejtim ngase autenciteti sjellë zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë.

Jeton Jagxhiu, në cilësinë e dashamirit të qytetit thekson se është shumë e evidente që u degrado qyteti, dhe se largimi i kubëzave ka ndikuar në masë të madhe në këtë drejtim. Ai përkujton se Prizreni nuk është qyteti i vetëm ku ka ndodh këso gabimi, ngase edhe në Pragë ka ndodh e njëjta praktikë, por kubëzat janë rishtruar pasi është kuptuar se ato kubëza i japin vlerë qytetit dhe janë dëshmi e trashëgimisë së Pragës.

Jagxhiu kërkon që kalldrëmi të kthehet komplet në të gjitha rrugët e pjesës qendrore të

Prizrenit, në mënyrë që të përmirësohet një gabim i së kaluarës. Argumentimi se ka qarkullim automjetesh të rënda për të nuk është i mjaftueshëm, ngase sipas tij kamionët e rëndë nuk kanë cka lypin në qendër të qytetit dhe se trashëgimia kulturore nuk mund të shkatërrohet shkaku i kamionëve. E sa i përket mirëmbajtjes ai thotë se vlera që kalldrëmi i jep qytetit është shumëfish më e madhe sesa vlera e mjeteve që harxhohen për mirëmbajtje.

Për ndodhitë e dekadës së fundit sipas Jagxhiut nuk kanë faj vetëm pushtetarët, por edhe qytetarët, sepse në mesin e tyre nuk ka ekzistuar vetëdija për këtë vlerë.

Për këtë shkak, Bekim Çeko, si studiues thekson se krahas kthimit të kalldrëmit, në Prizren duhet të kthehet edhe vetëdija e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe mënyra e trajtimit të saj, si potencial për zhvillim në fusha të ndryshme, ekonomi, social, etj.

Madje ai shkon tutje duke thënë se nuk duhet të marrim shembuj qytetet tjera, por të koncentrohemi vetëm te Prizreni, sepse ky qytet i ka të gjitha që nevojitet, duke nisur nga civilizimi i vet dhe vija historike e zhvillimit, që duhet të paraqiten dhe të trajtohen në mënyrë të duhur.

Asfalti, që konsiderohet si zbulim relativisht modern, sipas njohësve të kësaj fushe, nuk bën asgjë për rrugët e zonave historike. Është një shkatërrues i hapësirave dhe sipërfaqeve dhe kudo që të jetë e mundur duhet të hiqet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur e ka zëvendësuar me çmim të ulët kubëzat prej guri (Këshilli i Dizajnit 32). Ky trakt vazhdon tutje duke theksuar se kalldrëmi origjinal në zonat historike duhet të rivendoset, ose të paktën të rishtruhet me materiale lokale në

mënyrë që të arrijë "pjekurinë e menjëhershme" për rrethin²⁸.

X. Shembujt e qyteteve që mund të ndiqen

Berna e Zvicrës konsiderohet si njëri prej qyteteve që me kohë i ka kushtuar rëndësi ruajtjes së kalldrëmit në rrugët e vjetra. Në saje të këtij përkushtimi dhe ruajtjes së peizazhit mesjetar në qendrën e vjetër ky qytet është futur në Listën Botërore të UNESCO-s për Zonat e Trashëgimisë Kulturore, dhe atë në vitin 1983²⁹.

Për dallim prej Bernës, kryeqyteti i Republikës së Çekisë, Praga ka përjetuar fatin e Prizrenit, por në vitet e 80'ta të shekullit të kaluar. Pushteti komunist në atë kohë kishte larguar kalldrëmin për ta zëvendësuar me asfalt, përkundër kundërshtive të banorëve lokal. Një praktikë e tillë ka ndodhur edhe në qytetet tjera çeke. Mirëpo duke e parë vlerën e rrugëve me kubëza prej graniti si dhe disponimin e qytetarëve, vendbanimet çeke kanë filluar të rikthejnë kalldrëmin edhe në rrugët që ishin shtruar me asfalt³⁰.

Kalldrëmi klasik mbetet i popullarizuar në qytetet historike të Evropës kontinentale.

²⁸ "Excavating Cobblestones: Obsolescence and the Reinterpretation of Stones", Mark Treskon, 2006, <http://www.nyu.edu/classes/bkg/objectsblog/archives/cobblestones.pdf>

²⁹ Ueb faqja zyrtare e qytetit të Bernës, <http://www.bern.com/en/city-of-bern/attractions>, qasur më 14 qershor 2014

³⁰ "Bumping Forward", Adam Šura, <http://prague.tv/articles/art-and-culture/bumping-forward-respekt-cobblestones>, qasur më 14 qershor 2014

XI. Përfundim

Hulumtimi disa mujor i “EC Ma Ndryshe” ka nxjerrë në pah se sa komplekse është çështja e kalldrëmit dhe se i vlefshëm është ai për kontekstin historik të Prizrenit. Prandaj dhe vendimmarrja për heqjen e tij dhe zëvendësimin me asfalt nuk është dashur të bëhet me nguti e eufori, por vetëm pas studimeve e analizave të thukta dhe përfshirjes së gjerë të publikut në debat, në mënyrë që të krijohet konsensusi shoqëror për një ndryshim radikal në imazhin e qytetit.

Në të njëjtën kohë gabimet që janë evidentuar në këto projekte ‘euforike’ duhet të shërbejnë si përkujtues, në mënyrë që ato të mos përsëriten më. Për më shumë ato duhet të jenë pjesë e diskursit publik edhe sot në mënyrë që trashëgimia kulturore e qytetit të mos sakrifkohet për hir të mungesës së fondeve apo ekspertizës.

Po ashtu debati për mundësinë e kthimit të kalldrëmit në rrugët e Prizrenit duhet të jetë i vazhdueshëm, me qëllim që të gjenden mënyrat dhe burimet për realizimin e projekteve të tilla kapitale, që do të mundësonin kthimin e një vlere të humbur në rrugët e qytetit të vjetër.

XII. Për projektin

“Urbanism Watch” synon të instalojë një sistem të monitorimit permanent të aktivitetit shtetëror (në dy nivelet e qeverisjes) në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit urban në qytetin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të tij. Përmes të të gjeturave të monitorimit, ky sistem do të plotësohet me komponentët e publikimit dhe avokimit për të siguruar rend urbanistik në Prizren. Qëllimi themelor i projektit është të pengojë

degradimin e mëtejshëm urbanistik të Prizrenit dhe të ndikojë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm urban, përmes rritjes së transparencës dhe sigurimit të llogaridhënies në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

Arritja e këtij qëllimi synohet përmes objektivave si: Rritja e nivelit të informimit publik mbi menaxhimin dhe zhvillimin urban të qytetit; Krijimi i mekanizmit permanent të monitorimit dhe publikimit të të gjeturave mbi urbanizmin dhe planifikimin hapësinor të qytetit; Krijimi i presionit qytetar ndaj institucioneve shtetërore për të kërkuar përgjegjësi dhe llogari në raport me rregullsinë urbanistike të qytetit; Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe atyre që shpërfillin kriteret e ndërtimit brenda Qendrës Historike të qytetit; Procedimi i lëndëve tek gjyqësori dhe qeveria qendrore për shkeljet e identifikuar gjatë monitorimit. Projekti mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur.

XIII. Pse monitorimi i Urbanizmit të Prizrenit?

Periodha e pasluftës dhe tranzicioni në përgjithësi kanë sjellë me vete zhvillim të pakontrolluar edhe në Prizren, që është manifestuar me çintegrim urban, planifikim të pa-balancuar hapësinor, humbjen e tokës bujqësore e deri te degradimi i trashëgimisë natyrore në zonat rurale. Mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara të interesit, qoftë nga biznesi apo politika, në kurriz të ambientit jetësor të qytetarëve ka bërë që qyteti dhe zonat e mbrojtura natyrore të përfshihen nga një kaos urbanistik shkatërrimtar, pasojat e të cilit do të jenë afatgjate. Ndërtimet pa leje, përshtatja e

Planeve Rregullative Urbane nevojave të grupeve të interesit që merren me biznesin e ndërtimitarisë dhe mos krijimi i mekanizmave të kontrollit bashkë me mos veprimin e duhur institucional, duke nisur nga Drejtoria e Urbanizmit, Inspektorati e deri te organet e drejtësisë kanë bërë që Prizreni të përjetoj një degradim të pariparueshëm urbanistik, duke rrezikuar madje edhe bërthamën qendrore të Zonës Historike.

Një nga pasojat direkte të këtij kaosi urbanistik në Prizren dhe qytetet tjera të Kosovës ka qenë edhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, e cila nuk i ka shpëtuar viktimizimit nga sistemi i ri i “vlerave” pas lufte, që karakterizohet me mungesë totale të llogaridhënies e përgjegjësive dhe me kulturë të mosndëshkimit. Në një mjedis të tillë, investitorët në ndërtimtarinë kanë arritur që paratë e fituara në rrugë joformale t’i shpërlajnë përmes ndërtimeve të shumta, gjatë të cilit proces ata i kanë korrumpuar edhe zyrtarët e pushteteve lokale të Kosovës. Esencialisht, problemi qëndron në mosndalimin dhe mosndëshkimin e veprimtarisë ekonomike joformale nga institucionet e shtetit. Rrjedhimisht, është pothuaj absurde të pritet që i njëjti shtet të vendosë rregull dhe të ndalojë aktivitete degraduese ndërtimore në qendrat historike të qyteteve. Sektori i ndërtimeve në Kosovë vazhdon të jetë njëri ndër më të përfolurit për keqpërdorime dhe korrupsion. Konkretisht, disa zyrtarë të komunës së Prizrenit dhe disa kompani ndërtimi janë nën hetime nga Prokuroria Themelore për parregullsi urbanistike. E njëjta gjendje vlen edhe për Prishtinën, ku disa nga zyrtarët komunalë janë të përfshirë në kaosin urbanistik që e ka kapluar kryeqytetin.

Trekëndëshi themelor i urbanizmit brenda Qendrës Historike të Prizrenit përbëhet nga

Drejtoria për Urbanizëm, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore dhe Drejtoria për Inspektorat. Derisa e para lëshon leje urbanistike, e dyta jep pëlqime për respektimin e parimeve të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Ndërsa Inspektoratit i mbetet që të monitorojë procesin e ndërtimit bazuar në këto dy dokumente. Ajo që ndodh realisht brenda komunës së Prizrenit është se zyrtarët e urbanizmit thonë që janë në rregull me dokumentet dhe lejet e lëshuara, ndërsa përgjegjësia për tejkalime dhe ndërtime pa leje ia hedhin Inspektoratit. Këta të fundit thirren në buxhetin e pamjaftueshëm, numrin e vogël të inspektorëve dhe sidomos (ndonëse jo publikisht) në pamundësinë për t’ia ndalë punimet ndërtuesve, të cilët shpesh i përshkruajnë si “të fortë dhe të paprekshëm”. Në gjithë këtë situatë, ai që i ka emëruar drejtorët e këtyre dikasterëve, kryetari i komunës së Prizrenit flet për kërkesat që ia ka drejtuar drejtorëve të tij për të vënë rregull urbanistik në qytet, duke e shpërfaqur pafuqinë e tij ekzekutive. As Kuvendi i Komunës nuk mund të amnistohet nga kjo përgjegjësi, pasi që ky institucion e ka miratuar “Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit”, ndërsa asnjë herë nuk ka kërkuar përgjegjësi nga ekzekutivi i komunës për shkeljen me dy këmbë të këtij dokumenti.

Dimension tjetër i dështimit të shtetit është momenti kur në këtë pamje hyn gjyqësori. Drejtoria për Inspektorat ka ngjarë të ketë dërguar ndonjë kërkesë në Gjykatën për Kundërvajtje për të nisur proces gjyqësor ndaj ndërtuesve që i shpërfillin lejet e ndërtimit. Por kjo nuk ka sjellë kurrfarë rezultati, duke ia rikonfirmuar fuqinë dhe paprekshmërinë ndërtuesve. Për më tepër, Prokuroria e Qarkut (tash Themelore) ka vite që zhvillon hetime në urbanizëm, ndërsa ende nuk ka arritur të

shpallë aktakuzën, edhe pse dëshmitë janë shumë të dukshme dhe shumë shpesh të raportuara nga shoqëria civile dhe mediat. Në të njëjtën kohë, inspektorët e komunës gjatë punëve të inspektimit në terren, detyrohen të kërkojnë asistencë edhe nga Policia, e cila dërgon policë për të asistuar zyrtarët komunalë, por prezencja e tyre nuk i lehtëson aspak rrethanat e inspektimit.

Niveli qendror i përgjegjësisë institucionale për të mbrojtur qytetet është edhe më problematik. Janë disa ministri që kanë rol direkt dhe obligim ligjor për të parandaluar degradimin urbanistik dhe adresuar shkeljet. Ministrinë e kulturës, planifikimit hapësinor dhe pushtet lokal janë adresat kryesore në qeverinë qendrore, të mandatuara për të siguruar rend urbanistik në

qytete. Ministria e Kulturës, përmes Departamentit të vet të Trashëgimisë Kulturore dhe Qendrave Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, duhet të veprojë si autoriteti më i lartë shtetëror për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në rastin e Prizrenit, kjo ministri nuk ka ndërmarr asnjë veprim konkret për të adresuar kaosin urbanistik që po ndodh në Qendrën Historike të qytetit nga viti 1999. Në anën tjetër, Ministria e Planifikimit Hapësinor vazhdon të mbetet e heshtur karshi shkeljeve të Planit Hapësinor të Kosovës dhe planeve lokale urbane në Prizren. E fundit në këtë linjë të përgjegjësisë, Ministria e Pushtetit Lokal reagon tepër rrallë dhe shumë herë me butësi të pabesueshme karshi mosrespektimit të ligjshmërisë në miratimin e akteve komunale në Prizren.

Referencat

- Gillespie, William Mitchell, 1848. A Manual of the Principles and Practice of Road-Making: Comprising the Location, Construction, and Improvement of Roads (Common, Macadam, Paved, Plank, etc.) and Rail-Roads. New York: A. S. Barnes & Co.
- Roman roads in Croatia, A. Deluka, V. Dragcevic, T. Rukavina, Proceedings of the First International Congress on Construction History, Madrid, 20th-24th January 2003
- Setts & Cubes, <http://www.pavingexpert.com/setts01.htm>
- Komunikatë, CHwB, 2012-11-06, <http://chwb.org/kosovo/news/ne-perkrahje-te-vlerave-te-trasheguara-dhe-te-drejtes-se-komunitetit-per-ti-gezuar-ato/?lang=sq>
- Excavating Cobblestones: Obsolescence and the Reinterpretation of Stones, Mark Treskon, 2006, <http://www.nyu.edu/classes/bkg/objectsblog/archives/cobblestones.pdf>
- Portrete të Zonave Historike në Kosovë dhe rajonin ballkanik, broshurë, CHwB, mars 2011, <http://www.librariaelektronike.com/pdf/46>
- WSJ, "Europe's Unlikely Charmer", Stan Sesser, June 27, 2008, <http://online.wsj.com/news/articles/SB121452066620808827>
- Arkitektura Tradicionale dhe Metodatat e Dokumentimit, publikim i CHwB, Zyra e Kosovës, 2010, http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/06/CHwB-Kosovo-Report-15_2010_Traditional-architecture-and-documentation-methodologies.pdf
- ICOMOS, Karta e Venedikut, artikulli 9, http://www.icomos.org/charters/venice_e.pdf
- Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit, <http://www.online-transparency.org/repository/docs/Plani-i-konservimit.pdf>
- Udhëzuesi për zhvillimin e zonës historike të Prizrenit, <http://kk.rks.gov.net/prizren/getattachment/Projects/Planet-Rregullative/DARDANIA/PRIZREN-PP2-DCP-V6-JBAH-220310-ALB-final.pdf.aspx>
- Qendra Historike e Prizrenit: Zonë e (Pa)Mbrojtur, http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_UW-Qendra_Historike_Zone_e_%28Pa%29Mbrojtur.pdf
- Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme materiale në Kosovë", OSBE, Mars, 2014, <http://www.osce.org/sq/kosovo/117277?download=true>
- Excavating Cobblestones: Obsolescence and the Reinterpretation of Stones", Mark Treskon, 2006, <http://www.nyu.edu/classes/bkg/objectsblog/archives/cobblestones.pdf>
- Ueb faqja zyrtare e qytetit të Bernës, <http://www.bern.com/en/city-of-bern/attractions>
- Bumping Forward, Adam Šura, <http://prague.tv/articles/art-and-culture/bumping-forward-respekt-cobblestones>
- Refet Bushati, orëtar, intervistë, maj 2014
- Enver Batiu, historian, intervistë, maj 2014
- Hanefi Muharremi, ish-drejtor i Komunikacionit, Komuna e Prizrenit, intervistë, maj 2014
- Hasan Hasani, drejtor aktual i DSHP-së, intervistë maj 2014
- Sadik Paçarizi, ish-DSHP dhe Ish-DUPH, intervistë, maj 2014
- Hasan Hoti, drejtor i IMMh (QRTK), intervistë, maj 2014
- Bekim Çeko, arkitekt, intervistë, maj 2014
- Sali Shoshi, arkitekt, CHwB, intervistë, maj 2014
- Jeton Jaghriu, qytetar dhe aktivist, intervistë, maj 2014

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch – Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit–zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”.: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).